

CRNA GORA
MALI I ZI
SKUPŠTINA OPŠTINE ULCINJ
KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT
BR./NR. 02-262/19
Ulcinj,Ulqin, më 02. 11. 2019

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E JASHTËZAKONSHME
E KUVENDIT TË KOMUNËS SË ULQINIT

Mbledhja është mbajtur, më 31. 10. 2019 me fillim në orën 19:30 minuta.

Në mbledhje marrin pjesë të gjithë këshilltarët përveç: **Arsim Cuca, Gazmond Kaleziq, Sabri Salaj, Agron Mehmeti, Haki Mavriq dhe Majlinda Duraku.**

Pas konstatimit që ka kuorum Kryetari i Kuvendit ka theksuar që kjo mbledhje është thirrur në bazë të kërkesës së Kryetarit të komunës numër 01 – 1609/19 – 2 të datës 29. 10. 2019 dhe ai ka lexuar rendin e ditës të propozuar siç është në thirrjen numër: 02 – 269/19 të datës 30. 10. 2019 dhe pyetën se a kanë propozime apo ndryshime këshilltarët apo përfaqësuesit e ekzekutivit në lidhje me rendin e ditës të propozuar.

Pasi që nuk ka hedhur në votim këtë:

REND TË DITËS

1. Propozim Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për Buxhetin e Komunës së Ulqinit për vitin 2019 dhe
2. Propozim Vendimi për shitjen e tokës në pronësi të Komunës së Ulqinit.

Kuvendi me shumicë votash (pro 22, kundër 1, përmbajtur 3) ka miratuar rendin e ditës të propozuar.

Pika 1 Propozim Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për Buxhetin e Komunës së Ulqinit për vitin 2019

Kryetari thekson që propozues i këtij vendimi është Kryetari i Komunës ndërsa përpunues është Sekretariati për buxhet dhe financa.

Fjalën hyrëse për këtë pikë të rendit të ditës e ka paraqitur sekretari i Sekretariatit për buxhet dhe financa **Sead Osmanoviq.**

Bojan Gjakonoviq, kryetar i Këshillit për Statut dhe dispozita ka paraqitur raportin në të cilin ka theksuar që këshilli këtë pikë tashmë e ka shqyrtuar në mbledhjen e kaluar. Këshilli me këtë rast ka përfunduar që nuk ka kurrfarë pengesash ligjore që pika e përmendur të hyjë në shqyrtim të kuvendit, por është theksuar që të sigurohet pëlqimi nga Ministria e kompetente. Pasi që në ndërkohë e kemi fituar pëlqimin nga ministria përkatëse për këtë pikë të rendit të ditës Këshilli me shumicë votash ka nxjerrë përfundim që ky propozim mund të shkojë për shqyrtim në kuvend.

Haxhi Sulejmani, kryetar i Këshillit për financa, ekonomi dhe zhvillim ka paraqitur raportin për këtë pikë të rendit të ditës. Këshilli njëzëri e propozon për shqyrtim këtë propozim Vendim pasi që është fituar pëlqimi nga ministria përkatëse.

Pas kësaj Kryetari hapën debatin.

Sead Osmanoviq, sekretar i Sekretariatit për buxhet dhe financa ka theksuar që janë pranuar sugjerimet nga Shërbimi për punë të Kuvendit e të cilët kanë bërë fjalë për pikat që pika 41331 të jetë 5000 Euro, pika 4141 të jetë 3000, pika 4149 të jetë 12000, si dhe pika 4191 të jetë

6000. Pas kësaj në debat për këtë pikë të rendit të ditës kanë marrë pjesë: **Nazif Cungu, Luigj Shkrela dhe Arijan Murati**. Pasi që nuk ka pasur të paraqitur të tjerë për të diskutuar, Kryetari e mbyllën debatin dhe qet në votim Propozim Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për Buxhetin e Komunës së Ulqinit për vitin 2019. Kuvendi me shumicë votash (pro 23, kundër 2 dhe përmbajtur 2) ka nxjerrë Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për Buxhetin e Komunës së Ulqinit për vitin 2019.

Pika 2 Propozim Vendimi për shitjen e tokës në pronësi të Komunës së Ulqinit

Fjalën hyrëse për këtë pikë të rendit të ditës e ka paraqitur sekretari i Sekretariatit për mbrojtjen e pasurisë Ahmet Alosi.

Bojan Gjakonoviq, kryetar i Këshillit për Statut dhe dispozita ka paraqitur raportin, ku Këshilli ka konstatuar që kjo pikë e rendit të ditës mund të shkojë në Kuvend për t'u shqyrtuar pasi që është fituar pëlqimi nga Qeveria e Malit të Zi.

Haxhi Sulejmani, kryetar i Këshillit për financa, ekonomi dhe zhvillim ka paraqitur raportin, e Këshilli me shumicë votash i propozon Kuvendit që ta shqyrtojë pasi që është fituar pëlqimi nga Qeveria e Malit të Zi.

Xhavit Hoxhiq, kryetar i Këshillit për planifikim dhe rregullim të hapësirës ka paraqitur raportin duke theksuar që në këshill në debat lidhur me këtë pikë kanë marrë pjesë të gjithë anëtarët e këshillit dhe se tre anëtarë të këshillit kanë votuar "pro", 2 anëtarë kanë qenë të "përmbajtur" ndërsa 1 anëtar ka qenë "kundër".

Kryetari hapën debatin.

Kryetari i Kuvendit **Ilir Çapuni** e ka elaboruar këtë propozim Vendim dhe në fund ka propozuar Përfundimin që të obligohet Kryetari i Komunës të inicojë hartimin e një studimi për shpalljen e lokalitetit të Pyllit të pishave si një zonë me karakteristika të jashtëzakonshme, e kreu në kuptimin e nenit 26 dhe 28 të Ligjit për mbrojtjen e natyrës.

Në debatin e mëtejshëm lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kanë marrë pjesë këta këshilltarë: **Ilir Harasani, Haxhi Sulejmani, përfaqësuesi i qytetarëve Bekim Basha, Naser Resulbegoviq, Nazif Cungu, Luigj Shkrela, Arijan Ljamoviq, Borislav Bashoviq, Omer Bajraktari dhe Muamer Rashçiq**.

Fjalën përfundimtare lidhur me këtë pikë të rendit të ditës e ka paraqitur Kryetari i komunës Loro Nrekiq, i cili ka theksuar që në atë zonë nuk është paraparë ndërtimi i hoteleve të kategorive të larta si as objekte të mëdhenj duke theksuar se nuk do të ketë devastim të kësaj hapësire. Në fund ka propozuar që ky Vendim të miratohet.

Kryetari i Kuvendit **Ilir Çapuni** thekson që kemi dy propozime. I pari që Vendimi të miratohet me përfundimin e propozuar dhe e ka lexuar përfundimin e propozuar.

Bojan Gjakonoviq (procedurale) thekson që nuk e kemi praktikuar që të votojmë diçka që nuk ka kaluar nëpër këshilla pasi që nuk kemi asnjëfarë akti dhe ka shtuar që së pari duhet të votojmë për Vendimin e pastaj për përfundimin e propozuar.

Kryetari o komunës **Loro Nrekiq** propozon që të votojmë për këtë Vendimin e propozuar, që ky Vendim shkon drejtë ministrisë e pastaj të nxjerrim përfundimin i cili është propozuar nga Kryetari i Kuvendit.

Kryetari i Kuvendit **Ilir Çapuni** thekson që Kuvendi nxjerr propozime dhe përfundime, me këtë përfundim nuk ndryshon ky Vendim që është propozuar nga Kryetari i Komunës.

Borislav Bashoviq (procedurale) shtron pyetjen se cila është pika e rendit të ditës duke theksuar që Kuvendi deklarohet për pikën e rendit të ditës duke votuar pro ose kundër.

Pas kësaj Kryetari i Kuvendit qet në votim përfundimin të cilin ai e ka propozuar. Kuvendi me shumicë votash (pro 12, kundër 0, përmbajtur 6) e ka miratuar përfundimin e propozuar. Pas kësaj qet në votim Propozim Vendimin për dorëzimin e tokës në pronësi të Komunës së Ulqinit.

Ilir Harasani (procedurale) propozon që të votohet përmes thirrjes emër për emër në pajtim me Rregulloren.

Kryetari thekson që në pajtim me nenin 109 të Rregullores së punës së Kuvendit dhe e ka cituar “që këshilltarët mund të votojnë me thirrje emër për emër me propozimin e Kryetarit të Kuvendit ose me kërkesën e 10 këshilltarëve”, e pasi që këtë e ka propozuar vetëm këshilltari Ilir Harasani nuk janë 10 këshilltarë, e për këtë arsye propozoj si Kryetar i Kuvendit dhe fton Sekretarin që të bëjë thirrjen emër për emër. Qet në votim Propozim Vendimin për dorëzimin e tokës në pronësi të Komunës së Ulqinit. Pas kësaj Kryetari ka konstatuar që kanë votuar 27 këshilltarë, prej tyre “pro” 19, “kundër” 5 dhe “përmbajtur” 3 dhe ka konstatuar që Kuvendi e ka miratuar Vendimin për dorëzimin e tokës në pronësi të Komunës së Ulqinit.

Me këtë Mbledhja e jashtëzakonshme i ka përfunduar punimet në orën 23:00.

Procesverbalin e hartuan:

Sekretari

Kryetari

**Gjergj Pëggjonoviq
dhe Cufo Aliq**

Ardit Ceka

Dr. Ilir Çapuni